

Votat për garën për kryebashkiak të Stambollit po numërohen ende, tha të hënën Binali Y?ld?r?m, kandidati për kryebashkiak të Stambollit nga radhët e Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim (AK Parti), raporton Anadolu Agency (AA).

Y?ld?r?m tha se votat e pavlefshme në zgjedhjet e së dielës, gjithsej 319.500, dhjetëfish tejkalojnë diferencën e votave, duke shtuar se rivali i tij Ekrem Imamo?lu nga opozitarja Partia Republikane Popullore (CHP), aktualisht, siç duket, ka 25.000 vota më shumë.

"Ka gjithsej 31.136 kuti të votimit. Nëse një votë është plotësuar me parregullsi në çdo kuti të votimit, këto janë 31.136, që është më shumë se diferenca", tha Y?ld?r?m.

Ai gjithashtu falënderoi të gjithë banorët e Stambollit, duke theksuar se Komisioni i Lartë Zgjedhor i Turqisë do të duhet të thotë fjalën e fundit.

Shikuar në përgjithësi, të dhënat preliminare thonë se në zgjedhjet e së dielës kryeson partia turke në pushtet me 16 qytete të mëdha dhe 24 qytete tjera të fituara nga kandidatët e AK Partisë.

Miliona qytetarë të Turqisë votuan në zgjedhjet e së dielës për të zgjedhur kryetarët e rinj të komunave në Turqi, anëtarët e këshillave të qyteteve, përfaqësuesit e njësive më të vogla administrative, si dhe anëtarët e këshillave komunalë për pesë vitet e ardhshme.